



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KUKËS

VENDIM

Nr. 10 Datë 28.02.2025

PËR

**MIRATIMIN E RAPORTIT TË TRETË PERIODIK KATËRMUJOR OSE RAPORTI I
KONSOLIDUAR I ZBATIMIT TË BUXHETIT TË BASHKISË KUKËS
JANAR - DHJETOR 2024**

Këshilli Bashkiak Kukës, në mbledhjen e tij të datës së mësipërme, pasi shqyrtoi projektvendimin dhe relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Financës dhe buxhetit si dhe bazuar në ligjin Nr.139/2015, të miratuar me datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 8/2, 9/1/1.3/c, 54, ligjin Nr.44/2015, të miratuar me datë 30.04.2015 “Kodi i Proçedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, ligjin Nr.68/2017, të miratuar me datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, nenet 7 dhe 48, ligjin Nr.9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, (i ndryshuar), udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr.2, datë 06.02.2012 “Për proçedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, (i ndryshuar), udhëzimit nr.22 datë 30.07.2018 “Për proçedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njëjësive të vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimin Nr. 6, datë 28.02.2023 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2024-2026”, Vendimin e Këshillit Bashkiak Kukës Nr.82 datë 23.12.2022 “Për miratimin e Kalendarit të aktiviteteve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026 dhe të buxhetit vjetor 2024”, Vendimin e Këshillit të Bashkisë Kukës Nr.65 datë 22.12.2023, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2024”,

VENDOSI

1. Raportin e tretë periodik katërmujor ose raportin e konsoliduar të zbatimit të buxhetit të Bashkisë Kukës **Janar - Dhjetor 2024**, bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

KRYETARI I KËSHILLIT





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KUKËS

DREJTORIA FINANCËS DHE BUXHETIT

P/VENDIM

Nr. 11 Datë 24.02.2025

PËR

MIRATIMIN E RAPORTIT TË TRETË PERIODIK KATËRMUJOR OSE RAPORTI I KONSOLIDUAR I ZBATIMIT TË BUXHETIT TË BASHKISË KUKËS JANAR - DHJETOR 2024

Bazuar në ligjin Nr.139/2015, të miratuar me datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 8/2, 9/1/1.3/c, 54, ligjin Nr.44/2015, të miratuar me datë 30.04.2015 “Kodi i Proçedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, ligjin Nr.68/2017, të miratuar me datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, nenet 7 dhe 48, ligjin Nr.9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, (i ndryshuar), udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr.2, datë 06.02.2012 “Për proçedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, (i ndryshuar), udhëzimit nr.22 datë 30.07.2018 “Për proçedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësisë të vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimin Nr. 6, datë 28.02.2023 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2024-2026”, Vendimin e Këshillit Bashkiak Kukës Nr.82 datë 23.12.2022 “Për miratimin e Kalendarit të aktiviteteve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026 dhe të buxhetit vjetor 2024”, Vendimin e Këshillit të Bashkisë Kukës Nr.65 datë 22.12.2023, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2024”, i propozojmë Këshillit të Bashkisë Kukës për:

MIRATIM:

1. Raportin e tretë periodik katërmujor ose raportin e konsoliduar të zbatimit të buxhetit të Bashkisë Kukës **Janar - Dhjetor 2024**, bashkëngjitur këtij projekt - vendimi.

KRYETARI

Albert HALIDAJ





Raporti i tretë periodik katërmujor ose raporti i konsoliduar i zbatimit të buxhetit të Bashkisë Kukës, Janar - Dhjetor 2024

Sa i takon buxhetit vjetor për vitin 2024, Këshilli i Bashkisë Kukës ka miratuar me vendimin nr.65 date 22.12.2023, vendim i cili është konfirmuar nga institucioni i Prefeketit të Qarkut Kukës me shkresën nr 1/28 prot. date 05.01.2024 "Verifikim i ligjshmërisë së akteve", gjithashtu Programi Buxhetor Afatmesëm për Bashkinë Kukës për 2024-2026 është miratuar me vendimin nr.66 date 22.12.2023, nga Këshilli i Bashkisë Kukës, vendim i cili është konfirmuar nga institucioni i Prefeketit të Qarkut Kukës me shkresën nr 1/28 prot. date 05.01.2023 "Verifikim i ligjshmërisë së akteve".

Ndarja e fondeve është realizuar sipas programeve buxhetore ku janë mbajtur parasysh objektivat, qëllimet, produktet dhe përfituesit, nga ku janë përcaktuar dhe buxhetet për çdo program, të parashikuar në PBA për periudhën 2024-2026 dhe Buxhetin vjetor 2024.

Komuniteti vendor dhe grupet e interesit kanë dhënë kontributin e tyre dhe janë përfshirë plotësisht në hartimin e buxhetit të vitit 2024 dhe PBA-së 2024-2026, nëpërmjet dëgjimeve publike që janë organizuar nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, përkatësisht në datat 03.11.2023, si dhe konsultat publike të zhvilluara në Njësitë Administrative në datat 11;12;13 Dhjetor 2023, po kështu zhvillimi i pyetësorit online shpallur në faqen elektronike të Bashkisë kukesi.gov.al dhe mediat sociale të Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak kanë shërbyer për të marrë në konsideratë propozimet e publikut në prioritetet e zhvillimit me projekte konkrete.

Këshilli Bashkiak dhe administrata e Bashkisë Kukës nëpërmjet publikimeve në faqen zyrtare të Bashkisë, në mënyrë të vazhdueshme e kanë informuar publikun në lidhje me raportet periodike të monitorimit të buxhetit për periudhat përkatëse.

Raporti i Monitorimit të Zbatimit të Buxhetit të Bashkisë Kukës për periudhën 12-mujore Janar - Dhjetor 2024, ashtu si raportet e mëparshme, është hartuar në përputhje të plotë me udhëzimin nr.22 date 30.07.2018 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore".

Raporti i monitorimit të zbatimit të buxhetit është hartuar në mënyrë të përmbledhur dhe ka përmbajtjen si më poshtë:

Përmbajtja

1. Përmbajtja e raportit dhe lista e dokumentave shoqërues;
2. Hyrje;
3. Hapat e ndjekur në procesin e monitorimit të Buxhetit për periudhën Janar – Gusht 2024;
4. Plotësimi i formateve të përcaktuara (të gjitha anekset bashkëlidhur), ku të dhënat janë tërëkorduara me Degën e Thesarit Kukës, si për planin e buxhetit dhe realizimin faktik të shpenzimeve sipas Sistemit Informacionit Financiar të Qeverisë (SIFQ);
5. Raporti i shpenzimeve të Bashkisë Kukës sipas programeve (Aneksi nr.1)
6. Raporti i shpenzimeve të programeve sipas artikujve buxhetorë (Aneksi nr.2)
7. Raporti i treguesve të performancës (Aneksi nr.4)
8. Raporti i realizimit të treguesve financiarë (Shtojca 5)
9. Relacion shpjegues për çdo format të sipërpërmendur (Shtojca 2)
10. Projektet e investimeve të Bashkisë Kukës (Aneksi nr. 5)
11. Raporti për treguesit e raportit të gjendjes financiare (Shtojca 6)
12. Vlerësimi i Proceseve të Konsultimit Publik në Bashkinë Kukës (Shtojca 7)

Hyrje

Në mbështetje të nenit 104, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 65, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe nenit 48, të ligjit nr. 68, datë 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, udhëzimit nr.22 date 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore”, është hartuar dokumenti i Raportit periodik i zbatimit të buxhetit të Bashkisë Kukës për periudhën Janar - Dhjetor 2024, raport i cili informon Anëtarët e Këshillit të Bashkisë Kukës dhe të gjithë qytetarët mbi përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të Administratës së Bashkisë Kukës, mbi përdorimin e fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet për garantimin e qëndrueshmërisë së sistemit të menaxhimit financiar të Bashkisë Kukës për periudhën Janar – Dhjetor 2024.

Në aspektin e organizimit administrativ, Bashkia Kukës, përfshin në administrimin e vet Bashkinë qendër dhe 14 Njësi Administrative. Duke u bazuar në klasifikimin e ri të zonave urbane dhe rurale, Bashkia Kukës dallohet për karakterin e saj rural. Ajo përfshin 1 qendër urbane dhe 14 zona rurale. Nga pikëpamja e madhësisë së territorit, pjesa më e madhe i përket Njësisë Administrative Malzi, më përkatësisht 16.58 % të territorit e ndjekur nga Grykë Çajë me 9.97 %. Ndërsa pjesën më të vogël e zë qyteti i Kukësit me përkatësisht 1.41 % të totalit të territorit të Bashkisë së Kukësit.

Qyteti i Kukësit është qendra kryesore e Bashkisë Kukës dhe qendra më e rëndësishme si në aspektin ekonomik, administrativ, dhe atë social. Qendra të tjera ekonomike përfshijnë Bicaç, Shtiqën, Shishtavec dhe Shemri (Malzi). Pavarësisht këtyre qendrave ekonomike, Qyteti i Kukësit është vendi ku zhvillohet aktiviteti më i madh prodhues ekonomik, social-kulturor, tregtar, sportiv. Sa i takon hapave të ndjekur për periudhën Janar - Dhjetor 2024 në procesin e monitorimit të Buxhetit të Bashkisë Kukës, këto hapa janë të njëjtë, kështu janë ndjekur fazat e hartimit dhe përgatitjes së buxhetit dhe hapat që parashikon udhëzimi nr.23 date 30.07.2018 “Për procedurat standarde të hartimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore”, për fazën e parë:

- Përgatitja dhe shpërndarja e kalendarit të Programit Buxhetor Afatmesëm dhe i buxhetitvjetor
- Vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave
- Udhëzimi vjetor i ministrit të Financave dhe Ekonomisë për përgatitjen e buxhetit vendor
- Tavanet përgatitore të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm
- Udhëzimi i kryetarit të njësisë vendore për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm
- Përgatitja e kërkesave buxhetore mbi bazën e taveve paraprake
- Përgatitja e dokumentit të parë të Programit Buxhetor

Per fazen e dytë:

- Përgatitja dhe shpërndarja e udhëzimit plotësues për Programin Buxhetor Afatmesëm
- Përgatitja e Programit Buxhetor Afatmesëm të rishikuar
- Përgatitja e Programit Buxhetor Afatmesëm përfundimtar

Kurse sa i takon monitorimit dhe procedurave të kryera për monitorimin në Bashkinë Kukës, janë ndjekur me korrektësi hapat që parashikon udhëzimi nr.22 date 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore” si më poshtë:

- Procesi i raportimit mbi performancën për secilin program.
- Ecuria e treguesve të monitorimit të performancës së programeve.
- Raporti mbi të dhënat e treguesve të monitorimit të performancës së programeve.
- Ndryshime të mundshme në strukturën e planit të shpenzimeve.
- Masa e realizimit në përqindje të treguesve të performancës.
- Monitorimi i treguesve të performancës së programeve buxhetore sipas standardeve.
- Relacion shpjegues për mospërputhjet kundrejt planit të periudhës raportuese.
- Masat korrigjuese që duhen ndërmarrë në rast mospërputhjeje.
- Masat që kërkojnë vendimmarrje të kryetarit të Bashkisë apo Këshillit të Bashkisë.

- Transferim fondesh ndërmjet njësive shpenzuese të Bashkisë.
- Rishpërndarjet ndërmjet zërave të shpenzimeve korrente, brenda të njëjtit program.
- Raportet e monitorimit të të tre katërmujorëve përmbledhen në një raport përfundimtar monitorimi, i cili i dërgohet Këshillit të Bashkisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.


Raporti katërmujor për treguesit e gjendjes financiare të Bashkisë Kukës, dërgohet në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë në përputhje me afatet e përcaktuara në udhëzimin nr. 22, datë 30.07.2018, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore”, dhe formateve të aneksit 1, dhe aneksit 2, bashkëlidhur udhëzimit. Kështu Bashkia Kukës ka dërguar me Shkresën Nr.815 prot. datë 24.02.2025 “Dërgim i raportit të vetëvlerësimit, situata financiare Janar – Dhjetor 2024” të Bashkisë Kukës, sipas tabelave; Aneksi 1: Detyrimet ndaj të tretëve sipas vjetërsisë së tyre, situata financiare normale dhe rastet e vështirësive financiare; Aneksi 2: Treguesit fiskalë të konsoliduar të njësive të vetëqeverisjes vendore por edhe planin e hartuar për likuidimin e tyre, pasi në shkresën e Ministrisë Financave dhe Ekonomisë nr.5773 dt 29.03.2023 “Dërgohen mendimet për Raportin e konsoliduar të monitorimit të buxhetit 2022” për bashkinë Kukës jepen edhe rekomandime të cilat ne do t’i raportojmë për çdo periudhë katërmujore.

Ne do të mundohemi që ti reflektojmë këto rekomandime në të gjitha raportet, qofshin këto periodike dhe raportin e konsoliduar, që do të hartohen për monitorimin e zbatimit të buxhetit.

Të dhënat e treguesve të monitorimit të buxhetit sipas programeve për hartimin e raportit, kanë shërbyer së pari për tabelat e anekseve përkatëse dhe ilustrimet me grafiket si më poshtë dhe bashkë me to dhe për relacionin shpjegues të shpenzimeve të Bashkisë Kukës sipas programeve apo siç njihen në raportim aneksi nr.1 dhe shtojca nr.2

ANEKSI nr.1 "Raporti i Shpenzimeve sipas Programeve"

(në mijë lekë)




Titulli	Programet	Fakti i vitit paraardhës Viti 2023	PBA Viti 2024	Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2024	Buxheti	Fakti	%
01110	01110 - ADMINISTRATA	254,160	379,660	379,660	379,660	297,663	78
06260	06260 - SHERBIMET	259,772	243,358	243,358	329,654	272,151	83
01170	01170 - GJENDJA CIVILE	10,784	13,363	13,363	17,589	16,251	92
03280	03280 - MZSH	65,761	87,806	87,806	92,034	54,046	59
04240	04240 - UJITJA DHE KULLIMI	6,366	14,691	14,691	15,691	6,806	43
04260	04260 - SHERBIMI PYJOR	13,279	22,998	22,998	22,998	15,728	68
04520	04520 - RRUGET RURALE	27,953	32,431	32,431	43,183	22,723	53
04960	04960 - NDËRMJET LLOGARIVE NË QENDËR	16,900	7,801	7,801	16,730	9,240	55
08130	08130 - SPORTI	4,306	3,500	3,500	3,780	3,738	99
09120	09120 - ARSIMI PARASHKOLLOR	164,895	199,958	199,958	193,584	185,936	96
09230	09230 - KONVIKTI DHE ARSIMI I MESEM	113,747	80,946	80,946	48,289	26,473	55
10430	10430 - KUJDESI SOCIAL	896,560	418,706	418,706	892,914	889,950	100
03280	03280 - EMERGJENCA CIVILE: FONDE QEVE	4,609	8,167	8,167	30,039	22,698	0
06370	06370 - PROJEKTE UKK	20,207	20,207	20,207	1,638	1,424	87
Totali i Shpenzimeve të Njësive		1,859,298	1,533,593	1,533,593	2,087,782	1,824,829	87

Po kështu për hartimin e raportit mbi të dhënat e treguesve të monitorimit të buxhetit sipas artikujve buxhetor, ne kemi përdorur tabelat e anekseve përkatëse dhe ilustrimet me grafiqet si më poshtë dhe bashkë me to dhe relacionin shpjegues të shpenzimeve të Bashkisë Kukës sipas artikujve buxhetor apo siç njihen ndryshe në raportim aneksi nr.2 dhe shtojca nr.2.

Aneksi 2. Raporti i Shpenzimeve të programeve sipas artikujve

(në mijë lekë)




Artikulli	Emertimi	Fakti i vitit paraardhes Viti 2023	PBA Viti 2024	Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2024	Buxheti	Fakti	%
600	Paga	455,134	493,195	493,195	525,227	481,826	92
601	Sigurime Shoqërore	76,836	94,151	94,151	99,241	83,728	84
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	168,270	297,962	297,962	332,864	188,429	57
604	Transferta Korente të Brendshme	2,082	24,965	24,965	53,347	31,939	60
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	896,486	417,523	417,523	894,447	891,810	100
Nen - Totali	Shpenzime Korrente	1,598,807	1,327,797	1,327,797	1,905,126	1,677,732	88
230	Kapitale të Patrupëzuara	20,207	58,372	58,372	38,165	32,380	85
231	Kapitale të Trupëzuara	240,070	147,423	147,423	144,491	114,717	79
Nen - Totali	Shpenzime Kapitale me financim te brendshem	260,277	205,796	205,796	182,656	147,097	81
230	Kapitale të Patrupëzuara	3,072	-	-	-	-	
231	Kapitale të Trupëzuara	4,677	-	-	-	-	
Nen - Totali	Shpenzime Kapitale me financim te huaj	7,749	-	-	-	-	
Totali	Shpenzime Kapitale	268,025	205,796	205,796	182,656	147,097	81
Totali (korrente + kapitale)		1,866,833	1,533,593	1,533,593	2,087,782	1,824,829	87

Relacion shpjegues i shpenzimeve të Bashkisë Kukës sipas programeve (Shtojca 2)

Grafiku dhe tabela e mëposhtme për programin **01110- Menaxhim, Administrimi** tregojnë realizimin, masën e realizimit të objektivave dhe qëllimeve në raport me objektivat e këtij programindër të cilat rendisim disa prej tyre:


- ☐ Ndërtim i administratës së Bashkisë së Kukësit në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve, objektivave dhe përgjegjësisë ndaj qytetarëve.
- ☐ Burime njerëzore të trajnuara për kryerjen e funksioneve vendore.
- ☐ Sigurimi i shërbimeve mbështetëse për mirëfunksionimin e administratës së Bashkisë Kukës.
- ☐ Likuidimi i detyrimeve financiare të Bashkisë ndaj të tretëve.
- ☐ Ofrim cilësor i shërbimeve të gjitha administrative.
- ☐ Nxitja e punësimit të rinjve, vajza dhe djem përmes lehtësimit të procedurave të regjistrimit të bizneseve dhe zvogëlimi i burokracive tatimore.



Sipas të dhënave nga ditarët e shpenzimeve, ditarët e bankës dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit Kukës për periudhën 12-mujore Janar - Dhjetor 2024, shpenzimet në total për këtë program të cilat janë realizuar gjatë kësaj periudhe janë **297,663** mijë lekë dhe statusi i realizimit të buxhetit për këtë program ka qenë në masën **78 %**, të ndarë sipas artikujve shpenzimet kanë qenë, paga **207,849** mijë lekë ose **92,1%**, sigurime shoqërore **38,038** mijë lekë ose **91,2%**, mallra dhe shërbime të tjera **30,781** mijë lekë ose **41,1 %**, transferime për buxhetin familjar **495** mijë lekë ose **99 %**, Investime kapitale **0 %** e planifikimit.

Grafiku dhe tabela e mëposhtme për programin **06260- Shërbimet publike** në raport me objektivat e këtij programi ndër të cilat rendisim disa prej tyre:

- Përmirësimi i cilësisë së jetës së banorëve, përmes mjediseve të pastra.
- Sigurimi i mjediseve të gjelbëruar.
- Përmirësimi i cilësisë së dekorit, përshtatja me trendin e kohës, përdorimi i shumëfishtë i tij në të gjithë territorin e Bashkisë Kukës.
- Rritja e cilësisë së jetës së banorëve të qytetit dhe zonave rurale,
- Lehtësimi i lëvizjes së këmbësorëve dhe automjeteve.
- Nxjtja e zhvillimit industrial në Bashkinë Kukës përmes ngritjes së infrastrukturës.
- Krijimi i një sistemi adresash të saktë për të gjithë territorin e Bashkisë Kukës si mjet përpërmirësimin e shërbimeve dhe identitetit të qytetarit.
- Përmirësimi i cilësisë së mirëmbajtjes së varrezave publike.
- Përmirësimi i cilësisë së transportit të administratës në ofrimin e shërbimeve publike.




Sipas të dhënave nga ditarët e shpenzimeve, ditarët e bankës dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit Kukës, për periudhën 12-mujore Janar - Dhjetor 2024, shpenzimet në total për programin e **Shërbimeve Publike** të cilat janë realizuar gjatë kësaj periudhe njëvjeçare janë: **272,151** mijë lekë dhe statusi i realizimit të buxhetit për këtë program ka qenë në masën **83 %** të ndarë sipas artikujve

shpenzimet kanë qenë, paga **60,512** mijë lekë ose **85 %**, sigurime shoqërore **10,271** mijë lekë ose **76 %**, mallra dhe shërbime të tjera **126,516** mijë lekë ose **82,8 %**, Investime **62,814** mijë lekë ose **78,8 %** e planifikimit.

Grafiku dhe tabela e mëposhtme për programin **01170- Shërbimi i gjendjes civile** në raport me objektivat e këtij programi ndër të cilat rendisim disa prej tyre:


- Ofrimi i një shërbimi cilësor të Gjendjes Civile përmes lëshimit në kohë të dokumenteve bazësiç mund të jenë:
 - a) çertifikata e lindjes;
 - b) çertifikata martesore;
 - c) çertifikata familjare;
 - d) çertifikata e vdekjes;
 - e) dokumenta për letërnjoftimi dhe pasaporta;
 - f) vërtetime banimi, etj.




Sipas të dhënave nga ditaret e shpenzimeve, ditaret e bankës dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit Kukës për periudhën 12-mujore Janar - Dhjetor 2024, shpenzimet në total për këtë program të cilat janë realizuar gjatë kësaj periudhe janë **16,251** mijë lekë dhe statusi i realizimit të buxhetit për këtë program ka qenë në masën **92,4 %**, të ndarë sipas artikujve shpenzimet kanë qenë, shpenzime për paga **11,643** mijë lekë, ose **91,4 %**, për sigurime shoqërore **1,944** mijë lekë ose **91,4 %**, dhe transfertat për buxhetin familjar **2,664** mijë lekë ose **98,1 %**.

Grafiku dhe tabela e mëposhtme për programin **03280- Mbrojtja nga zjarri dhe shpëtimi** në raport me objektivat e këtij programi ndër të cilat rendisim disa prej tyre:

- Krijimi i skemës funksionale të burimeve njerëzore dhe logjistike për menaxhimin mbrojtës nga zjarri dhe shpëtimin si dhe plotësimi i kushteve të sigurisë për mbrojtjen kundër zjarrit për të gjithë objektet në pronësi të Bashkisë Kukës.
- Ofrimi i një shërbimi të qëndrueshëm për emergjencat civile në çdo pjesë të territorit të Bashkisë Kukës përmes ngritjes së strukturës së vullnetarëve civilë si pjesë e rëndësishme estrukturave të mbrojtjes civile.



Sipas të dhënave nga ditarët e shpenzimeve, ditarët e bankës dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit Kukës për periudhën 12-mujore Janar - Dhjetor 2024, shpenzimet në total për këtë program të cilat janë realizuar gjatë kësaj periudhe një vjeçare janë: **54,046** mijë lekë dhe statusi i realizimit të buxhetit për këtë program ka qenë në masën **59 %**, të ndarë sipas artikujve shpenzimet kanë qenë, shpenzime për paga **38,525** mijë lekë ose **87,2 %**, sigurime shoqërore **6,424** mijë lekë ose **74,6 %**, shpenzime për mallra dhe shërbime të tjera **8,915** mijë lekë ose **23,2 %**, dhe transfertat per buxhetin familjar **181** mijë lekë ose **35.5%**. Investime **0** lekë




Në planet për **Emergjencat Civile**, që hartohen bazuar në strategjitë për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, dokumentet e vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë natyrore, kapacitetet e mbrojtjes civile, edhe përvojat e fituara në menaxhimin e fatkeqësive, përfshihen edhe financimet nga qeveria për familjet e dëmtuara nga fatkeqësitë natyrore në Bashkinë Kukës, që për vitin 2024 janë akorduar për këtë program **30,039** mijë lekë por deri sot janë realizuar **22,698** mijë lekë ose **82.2 %** e planifikimit.

Ju informojmë se për programin **04130- Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB)** Për periudhën 12-mujore Janar - Dhjetor 2024, shpenzimet në total për këtë program të cilat janë realizuar gjatë kësaj periudhe janë **0** lekë, pasi Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Qendra Kombëtare e Biznesit, me shkresën Nr.11593/2 Prot. Datë 28.04.2022 ka dërguar Urdhërin Nr.139 datë 28.04.2022 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për mbylljen e sporteleve të shërbimit pranë njësive të qeverisjes vendore dhe bashkimit të dhomave të tregëtisë dhe industrisë dhe/ose të tregëtisë”, kështu që për vitin 2024 shpenzimet e programit 04130- Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) janë **0(zero)** lekë.

Grafiku dhe tabela e mëposhtme për programin **04240- Ujitja dhe Kullimi** në raport me objektivat e këtij programi ndër të cilat rendisim disa prej tyre:


- Administrimi i infrastrukturës vendore të ujitjes dhe kullimit të tokave;
- Ndërtimi i veprave të reja të infrastrukturës vendore të ujitjes dhe kullimit;
- Menaxhimi i institucionit në shërbim të këtij funksioni, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;



Sipas të dhënave nga ditarët e shpenzimeve, ditarët e bankës dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit Kukës për periudhën 12-mujore Janar - Dhjetor 2024, shpenzimet në total për këtë program të cilat janë realizuar gjatë kësaj periudhe një vjeçare janë: **6,806** mijë lekë dhe statusi i realizimit të buxhetit për këtë program ka qenë në masën **43,4 %**, të ndarë sipas artikujve shpenzimet kanë qenë, paga **1,017** mijë lekë **52,6 %**, dhe sigurime shoqërore **170** mijë lekë **26,3%**, mallra dhe shërbime të tjera **5,565** mijë lekë ose **51,6 %** e planifikimit.

Grafiku dhe tabela e mëposhtme për programin **04260- Menaxhimi i pyjeve** në raport me objektivat e këtij programi ndër të cilat rendisim disa prej tyre:


- ☐ Regjistrimin e fondit pyjor dhe kullësor në ZRPP;
- ☐ Rehabilitim, pyllëzim dhe ripyllëzim të sipërfaqeve, të degraduara, djegura dhe rehabilitimin ekullotave.
- ☐ Evidentimi për zjarret e rënë në pyjet dhe kullotat që administrojnë apo kanë në pronësi dheraportim për të dhënat statistikore, në përputhje me përcaktimet e dispozitave ligjore.
- ☐ Parandalimi i gjërryerjes së mëtejshme të tokës pyjore dhe kullësore.



Sipas të dhënave nga ditaret e shpenzimeve, ditaret e bankës dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit Kukës për periudhën 12-mujore Janar - Dhjetor 2024, shpenzimet në total për këtë program të cilat janë realizuar gjatë kësaj periudhe një vjeçare janë: **15,728** mijë lekë dhe statusi i realizimit të buxhetit për këtë program ka qenë në masën **68,4 %**, të ndarë sipas artikujve shpenzimet kanë qenë, paga **8,091** mijë lekë ose **66,9 %**, sigurime shoqërore **1,349** mijë lekë ose **53,2 %**, mallra dhe shërbime të tjera **1030** mijë lekë ose **35,3 %**, investime kanë qenë, paga **5,259** mijë lekë ose **100 %** e planifikimit.

Grafiku dhe tabela e mëposhtme për programin **04520- Rrugët rurale** në raport me objektivat e këtij programi ndër të cilat rendisim disa prej tyre:


- ☐ Përmirësimi i rrjetit të rrugëve vendore dhe trotuareve në Bashkinë Kukës.
- ☐ Lehtësimi i lëvizjes së banorëve të qytetit përmes rehabilitimit të infrastrukturës rrugore
- ☐ Nxitja e turizmit në rajon përmes ndërtimit të infrastrukturës rrugore strategjike.
- ☐ Lehtësimi i lidhjes së banorëve të bashkisë me pikat e kalimit ndërkombëtar.
- ☐ Lehtësimi i lëvizjes së banorëve në zonat e bashkisë përmes pastrimit të rrugëve nga dëbora.
- ☐ Lehtësimi i lëvizjes së banorëve në zonat rurale të bashkisë përmes rehabilitimit të infrastrukturës rrugore.



Sipas të dhënave nga ditaret e shpenzimeve, ditaret e bankës dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit Kukës për periudhën 12-mujore Janar - Dhjetor 2024, shpenzimet në total për këtë program të cilat janë realizuar gjatë kësaj periudhe një vjeçare janë: **22,723** mijë lekë dhe statusi i realizimit të buxhetit për këtë program ka qenë në masën **52,6 %**, të ndarë sipas artikujve shpenzimet kanë qenë, paga **4,976** mijë lekë ose **74,9%**, sigurime shoqërore **578** mijë lekë ose **39,3 %**, shpenzime operative për mallra e shërbime të tjera **6,416** mijë lekë ose **26,6 %**, investime **10,752** mijë lekë ose **100%** e planifikimit.

Grafiku dhe tabela e mëposhtme për programin **09120- Arsimi Parashkollor** në raport me objektivat e këtij programi ndër të cilat rendisim disa prej tyre:


- ☐ Rritja e efektivitetit të përdorimit të fondeve për arsimin dhe zhvillimi e shfrytëzimi cilësor i infrastrukturës së institucioneve arsimore në Bashkinë Kukës.
- ☐ Rritja e cilësisë së jetës kulturore e sportive të bashkisë.
- ☐ Zhvillimi i talenteve të reja në fushën e artit dhe kulturës si dhe pasurimi e gjallërimi i jetës kulturore e artistike.
- ☐ Promovimi i nxënësve të dalluar në mësimet përmes aktiviteteve kulturore dhe argëtuese.
- ☐ Përfshirja e të rinjve në aktivitete rinore me tematika të ndryshme.
- ☐ Rritja e cilësisë së mësimdhënies përmes ngritjes/rehabilitimit të infrastrukturës arsimore rishpërndarja më optimale e numrit të nxënësve në shkollat e qytetit të Kukësit.



Sipas të dhënave nga ditarët e shpenzimeve, ditarët e bankës dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit Kukës për periudhën 12-mujore Janar - Dhjetor 2024, shpenzimet në total për këtë program të cilat janë realizuar gjatë kësaj periudhe një vjeçare janë: **185,936** mijë lekë dhe statusi i realizimit të buxhetit përkëtë program ka qenë në masën **96 %**, të ndarë sipas artikujve shpenzimet kanë qenë, paga **128,827** mijë lekë ose **100 %**, sigurime shoqërore **21,558** mijë lekë ose **89 %**, mallra dhe shërbime të tjera **1,571** mijë lekë ose **37 %**, transferime për buxhetin familjar **340** mijë lekë ose **85 %**, investime kapitale **33,640** mijë lekë ose **94 %** e planifikimit.

09230- Arsimi Parauniversitar dhe Konvikti në raport me objektivat e këtij programi ndër të cilat trendisim disa prej tyre:

- ☐ Rritja e efektivitetit të përdorimit të fondeve për arsimin e mesëm dhe konviktin dhe zhvillimie shfrytëzimi cilësor i infrastrukturës së institucioneve arsimore për arsimin e mesëm dhe konviktin në Bashkinë Kukës.
- ☐ Rritja e cilësisë së jetës kulturore e sportive të bashkisë.
- ☐ Zhvillimi i talenteve të reja në fushën e artit dhe kulturës si dhe pasurimi e gjallërimi i jetëskulturore e artistike.
- ☐ Promovimi i nxënësve të dalluar në mësimet përmes aktiviteteve kulturore dhe argëtuese.
- ☐ Përfshirja e të rinjve në aktivitete rinore me tematika të ndryshme.
- ☐ Rritja e cilësisë së mësimdhënies për arsimin e mesëm dhe konviktin përmes ngritjes/reabilitimit të infrastrukturës arsimore rishpërndarja më optimale e numrit të nxënësve në shkollat e qytetit të Kukësit.




Sipas të dhënave nga ditarët e shpenzimeve, ditarët e bankës dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit Kukës për periudhën 12-mujore Janar - Dhjetor 2024, shpenzimet në total për këtë program të cilat janë realizuar gjatë kësaj periudhe një vjeçare janë: **26,473** mijë lekë dhe statusi i realizimit të

buxhetit përkëtë program ka qenë në masën **55 %** të ndarë sipas artikujve shpenzimet kanë qenë, paga **18,563** mijë lekë ose **99,2 %**, sigurime shoqërore **3,090** mijë lekë ose **81,3%**, mallra dhe shërbime të tjera **3,897** mijë lekë ose **18,8 %**, transferime për buxhetin familjar **94** mijë lekë ose **47,1 %**, dhe investime kapitale **828** mijë lekë ose **17 %** e planifikimit.


Grafiku dhe tabela e mëposhtme për programin **10430- Kujdesi Social** në raport me objektivat eketij programi ndër të cilat rendisim disa prej tyre:

- ☐ Mbështetja financiare e shtresave në nevojë përmes përfshirjes së tyre në projekte për NdihmënEkonomike dhe Paaftësinë.
- ☐ Mbështetja financiare e shtresave në nevojë përmes ndërtimit të banesave për strehim social.
- ☐ Ofrimi i shërbimit të strehimit për familjet e pastreha në Bashkinë e Kukësit.
- ☐ Nxitja e punësimit të rinjve, vajza dhe djem përmes trajnimeve profesionale në fusha tëndryshme.




Sipas të dhënave nga ditarët e shpenzimeve, ditarët e bankës dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit Kukës për periudhën 12-mujore Janar - Dhjetor 2024, shpenzimet në total për këtë program të cilat janë realizuar gjatë kësaj periudhe një vjeçare janë: **889,950** mijë lekë dhe statusi i realizimit të buxhetit për këtë program ka qenë në masën **100 %**, të ndarë sipas artikujve shpenzimet kanë qenë, paga **1,823** mijë lekë ose **56,9 %**, sigurime shoqërore **304** mijë lekë ose **51,5 %**, transferime për buxhetin familjar (ndihmë ekonomike dhe paaftësi) **887,823** mijë lekë ose **99,9 %** e planifikimit.


Për programin **06370 - Projekte për UKK**, në grafikun dhe tabelën më poshtë shihen shpenzimet e kryera nga Bashkia Kukës për projektet me fonde qëndrore, që për rastin konkret kanë të bëjnë me ujësjellës kanalizimet që për periudhën 12-mujore Janar - Dhjetor 2024 janë alokuar **1,638** mijë lekë dhe janë shpenzuar për këtë zë **1,424 mijë** lekë ose **87 %** e tij.



Për programin **04960 - Ndërmjet Llogarive në qendër (Janar – Dhjetor 2024)**, në grafikun dhe tabelën më poshtë shihen shpenzimet e kryera nga Bashkia Kukës për projektet me fonde qëndrore, që për rastin konkret kanë të bëjnë me parafinancimet, pagesën e TVSH-së dhe detyrimet e prapambetura të këtyre projekteve për periudhën 12-mujore Janar - Dhjetor 2024, ku në total janë alokuar për hartim projekti vlera **16,730** mijë lekë dhe janë shpenzuar për këtë zë **9,240** mijë lekë ose **55.2 %**, e tij.



Kështu ne informojmë Këshillin e Bashkisë Kukës se për realizimin e të gjitha shërbimeve dhe produkteve të mësipërme sipas programeve në krahasim me planin e miratuar në buxhetin e vitit 2024, si në terma sasiorë ashtu edhe në cilësi janë ndjekur dhe respektuar nga ana e Ekipeve të Menaxhimit të Programeve, normativat dhe standardet ligjore dhe kostot për njësi, si dhe janë analizuar nga EMP-të dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS në tre mbledhjet e zhvilluara me datë 31.05.2024 për Draftin e parë të PBA 2025-2027, si dhe në mbledhjet e zhvilluara me datë 06.09.2024 për Draftin e Rishikuar të PBA 2025-2027 dhe me datë 26.12.2024 Shqyrtimi i draftit Final të Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 të Bashkisë Kukës dhe Buxhetit Vjetor 2025, është raportuar për monitorimin e zbatimit të buxhetit) argumentet konkrete lidhur me rishikimin ose jo të politikës së programit apo propozime të tjera të administratës së Bashkisë Kukës për përmirësimin e situatës në Bashki dhe në 14 Njësitë Administrative të saj.



Përmbledhje e raportit shpenzimeve të Bashkisë Kukës sipas artikujve buxhetorë (Aneksi 2)

Titulli	Programet	Fakti i vitit paraardhës Viti 2024	PBA Viti 2025	Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2025	Buxheti	Fakti	%
600	Paga	455,134	493,195	493,195	525,227	481,826	92
601	Sigurime Shoqërore	76,836	94,151	94,151	99,241	83,728	84
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	168,270	297,962	297,962	332,864	188,429	57
604	Transferta Korente të Brendshme	2,082	24,965	24,965	53,347	31,939	60
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	896,486	417,523	417,523	894,447	891,810	100
Nen - Totali	Shpenzime Korrente	1,598,807	1,327,797	1,327,797	1,905,126	1,677,732	88
230	Kapitale të Patrupëzuara	20,207	58,372	58,372	38,165	32,380	85
231	Kapitale të Trupëzuara	240,070	147,423	147,423	144,491	114,717	79
Nen - Totali	Shpenzime Kapitale me financim te brendshem	260,277	205,796	205,796	182,656	147,097	81
230	Kapitale të Patrupëzuara	3,072	-	-	-	-	
231	Kapitale të Trupëzuara	4,677	-	-	-	-	
Nen - Totali	Shpenzime Kapitale me financim te huaj	7,749	-	-	-	-	
Totali	Shpenzime Kapitale	268,025	205,796	205,796	182,656	147,097	81
Totali (korrente + kapitale)		1,866,833	1,533,593	1,533,593	2,087,782	1,824,829	87

Relacion i shpenzimeve të Bashkisë Kukës sipas artikujve buxhetorë (Shtojca 2)

Në tabelat dhe grafikun më sipër konstatohet qartë se, për sa i takon Buxhetit të Bashkisë Kukës sipas llogarive ekonomike për periudhën 12-mujore Janar - Dhjetor 2024 në total është realizuar në shumën **1,824,829** mijë lekë ose në masën **87 %** i planifikimit të këtij buxheti, ku: Në zërin “Investime” buxheti është realizuar në shumën **147,097** mijë lekë ose në masën **81 %** e totalit të përgjithshëm të shpenzimeve të buxhetuara për investime. Në zërin paga, buxheti është realizuar në shumën **481,826** mijë lekë, dhe në krahasim me buxhetin kjo llogari ekonomike zë **92 %** të volumit të përgjithshëm vjetor të shpenzimeve për paga. Në zërin shpenzime “Për sigurime shoqërore dhe shëndetësore” buxheti është realizuar në shumën **83,728** mijë lekë, ose **84 %** e volumit të përgjithshëm vjetor të shpenzimeve për sigurime shoqërore. Në zërin shpenzime operative buxheti është realizuar në shumën **188,429** mijë lekë ose **57 %** të volumit të përgjithshëm vjetor të shpenzimeve operative të buxhetuara për vitin 2024 “Ndihma ekonomike dhe pafhtësia” janë realizuar në shumën **891,810** mijë lekë ose afro **100 %** të volumit të përgjithshëm të shpenzimeve vjetore (të buxhetuara nga Qeveria brenda vitit 2024) për vitin 2024 për ndihmën ekonomike dhe pafhtësisë, Transferta Korente të Brendshme janë realizuar në shumën **31,939** mijë lekë ose **60 %** e buxhetuara për këtë artikull.

Relacion mbi realizimin e të ardhurave të veta të Bashkisë Kukës.

Autonomia fiskale, u garanton njësitë të vetëqeverisjes vendore, të drejtën për të vendosur e mbledhur taksa dhe tarifa vendore ne perputhje me kërkesat e percaktuara ne ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 *(i ndryshuar)*. Çdo njesi e vetëqeverisjes vendore, synon ne drejtim te krijimit te burimeve financiare të nevojshme, për realizimin e funksioneve të saj.

Taksat dhe tarifat vendore, përbëjnë një burim të rëndësishëm financiar të buxhetit të pushtetit vendor. Reforma e decentralizimit ka bërë që shumë kompetenca dhe funksione të pushtetit qendror, të transferohen në pushtetin vendor.

Taksat dhe tarifat vendore, janë pagesa të detyrueshme dhe të pakthyeshme në buxhetin e organeve të vetëqeverisjes vendore, të vendosura me ligj dhe që paguhen nga çdo subjekt i cili ushtron një aktivitet ekonomik apo përfiton një shërbim publik në territorin e Bashkisë Kukës.

Parashikimi i të ardhurave për Bashkinë Kukës është mbështetur kryesisht në llogaritjet e kapacitetit të taksave e tarifave, informacion i përfituar nga programi i taksave vendore, në ecurinë e realizimit të tyre në dy vitet e para si dhe ne politikat e percaktuara për periudhën në vijim, duke u mbështetur në aktet ligjore për to.




Bashkia Kukës si njësi e qeverisjes vendore ka zbatuar detyrimin ligjor për mbledhjen e të ardhurave si dhe menaxhimin e tyre. Afati i fundit i pagesës së taksave dhe tarifave vendore për të cilën subjektet përfitojnë një premio prej 5% të detyrimit total është data 20 Prill, pas këtij afati subjekti ngarkohet me detyrimin e plotë plus 0.06% kamatë vonese për çdo ditë vonese të pagesës.




Nga Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Liçensave të Bashkisë Kukës dhe nga VKB Nr.06 dt.26.01.2024 “Për miratimin e raportit për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave të Bashkisë Kukës” është parashikuar në buxhetin e vitit 2024 plani i të ardhurave në shumën **146,582,000** lekë, sigurimi dhe vjelja e të ardhurave për Bashkinë Kukës ka filluar nga data 01 Janar 2024 dhe deri me datë 31 Dhjetor 2024 janë mbledhur **216,090,611** lekë të ardhura si në tabelën e mëposhtme, ose në vlerë absolute 147% e planifikimit, por kjo shumë është siguruar nga detyrimet që kanë ndaj bashkisë bizneset dhe personat e tatueshëm dhe mbledhja e detyrimeve të prapambetura nga gjobat e vendosura për mos pagimin në afat të detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore, si dhe të ardhura nga nivele të tjera qeverisje, kjo e bën të mundur realizimin e objektivave dhe ofrimin e shërbimeve dhe produkteve, si dhe rritjen e performancës së institucionit të Bashkisë Kukës.




TE ARDHURAT E BASHKISË KUKËS (Janar - Dhjetor 2024)		
LLOGARIA	PERSHKRIMI	Janar - Dhjetor 2024
7002200	Tatim i thjeshtuar mbi fitimin	616,040
7020100	Tatim mbi token bujgesore	54,723
7020200	Tatim mbi Ndertesat	18,355,430
7021100	Tatim, Shitja e pasurise se paluajtshme	1,710
7029200	Taksa per Kalimin e te drejtes se pronesise se Pasurise se paluajtshme	37,404
7035002	Takse per zenien e hapësirave publike.	541,964
7035003	Takse e ndikimit ne ifranstrukture nga ndertimet e reja.	6,486,119
7035005	Takse per fjetjen ne hotel.	90,440
7035008	Takse per reklamat	514,602
7035009	Taksa e tabelës	911,602
7035013	Taksa vendore e gjelbert	157,400
7035022	Taksa për përdorimin e hapësirës publike për mbajtjen e materialeve ndërtimore	1,259,244
7035023	Tarife ndricimi per bizneset dhe familjaret	342,750
7035025	Takse vendore mbi truallin	658,419
7035029	Tarife vendore per leje ndertimi	5,000
7035032	Takse vendore per shqyrtim lejesh nga urbanistka	650,715
7035035	Takse vendore mbi ndotjen (Dentime ne infrastrukture, Mjedis, Komunitet)	24,038,850
7035039	Tarife per dhenje license per tregetim naftë dhe nenprodukteve te saj	1,000,000
7035046	Takse e perkohshme per linjat ajrore, nentokesore (Tel, Internet, Energji)	97,692
7109101	Tarife per dhenje me kontrate qiraje nga fondi pyjor dhe kullota	4,670,713
7109300	Te ardhura nga renta minerare ose karrieres	770,625
7109600	Qira nga Ndertesat	1,397,000
7110106	Tarifa per leje transporti.	1,871,715
7110500	Tarifa Administrative Dhe Rregullatore te njesive vendore	301,750
7110501	Tarifa pastrimi dhe higjene	37,980,590
7110511	Tarifa per regjistrimin e prones	130,686
7111001	Te ardhura nga kopshtet e femijeve	6,871,060
7111002	Te ardhura nga çerdhet	2,453,199
7111003	Te ardhura nga Qendrat e Formimit Profesional	416,939
7111007	Te ardhura nga parkingu.	404,928
7113006	Shitja e shtypshkrimeve	3,000
7113009	Te ardhura miratim projekti MNZ	46,000
7115001	Gjoha, kamatevonesa, sekuestrime dhe zhdentime	12,000
7115499	Te tjera gjoha - Detyrime te viteve te meparshme	36,485,518
7115500	Kamatevonesa	1,003,168
7204101	Grante Nj.Vendore nga Pjesmarria në Takën Vjetore për Qarkullimin e mjeteve të përdorura	32,025,476
7204102	Grante Nj.Vendore nga Pjesmarria në Tatim mbi të Ardhurat Personale	19,983,861
7211100	Grante Nga Qeveri te Huaja	13,442,279
	TOTALI I TE ARDHURAVE	216,090,611

Realizimi i treguesve të performancës të Buxhetit të Bashkisë Kukës (Aneksi nr.4)

Sipas udhëzimit nr.22 date 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore” për treguesit e performancës, fillimisht përcaktohen vlerat bazë të treguesve të performancës dhe vendosen synime realiste. Për të gjitha funksionet e veta ligjore Bashkia Kukës ka monitoruar të gjitha programet e shpenzimeve të saj duke krijuar një sistem administrimi të performancës së shërbimeve administrative dhe shërbimeve publike që Bashkia Kukës ofron për komunitetin Kuksian bazuar mbi standarde vendore dhe standarde minimale kombëtare. Për këtë qëllim, Bashkia Kukës ka hartuar një sistem treguesish performance, tregues keto që janë të pasqyruara në dokumenta të tilla financiare siç janë buxheti vjetor i vitit 2024 dhe Programi Buxhetor Afatmesëm PBA i Bashkisë Kukës dhe së fundi ky sistem treguesish performance është programuar të shfaqet në SMBV.







Ekipeve të Menaxhimit të Programeve (EMP-të) dhe drejtuesit e tyre, për të rritur efektivitetin, kanë përcaktuar në nivel produktesh dhe rezultatesh konkrete treguesit e performancës. Treguesit në nivel produkti, disa prej të cilave të paraqitura në grafikët e mësipërm tregojnë produkte dhe shërbime që janë ofruar banorëve të Bashkisë Kukës për arritjen e objektivave gjatë periudhës një vjeçare Janar – Dhjetor 2024, por duhet theksuar se gjatë kësaj periudhe një vjeçare Drejtuesit e Ekipeve të Menaxhimit të Programeve (Respektivisht Drejtorët e Drejtorive përkatëse të Bashkisë, kanë qenë të angazhuar në përshtatjen e buxhetimit dhe raportimit të monitorimit të buxhetit për secilin program sipas kërkesave që imponon përdorimi i Sistemit të Menaxhimit të Buxhetit Vendor, (SMBV) sipas Udhëzimit Nr.3 datë 28.02.2024 “Për Përgatitjen e Programit Buxhetor

Afatmesëm Vendor 2025-2027, përdorimi i këtij sistemi në rang kombëtar do të ndikojë në përmirësimin më tej të performancës së qeverisjes vendore, në këtë kuadër qeveria shqiptare mbetet e angazhuar për një Sistem të Menaxhimit të Performancës (SMP) për bashkitë sipas ligjit 139 për vetëqeverisjen vendore, ligjit Nr.68 për financat vendore dhe Strategjisë për Decentralizim të Vetëqeverisjes Vendore.

Aplikacioni SMBV është një platformë elektronike e instaluar në një kompjuter server (pra është online dhe i aksesueshëm nëpërmjet internetit) ku Drejtoria e Financave Vendore në Ministrinë e Financave dhe Bashkia janë përgjegjëse për menaxhimin e të drejtave të përdoruesve në këtë sistem. Sigurimi i aksesit në aplikacion kryhet në bashkëpunim ndërmjet Sekretarit të GMS-së, stafit të IT-së të Bashkisë dhe Drejtorisë së Financave Vendore në Ministrinë e Financave, me mbështetjen e Projektit Financat Lokale, për periudhat e tjera të raportimit raportet do të gjenerohen nga vetë SMBV-ja dhe e mira e kësaj pune përveç të tjerave do të jetë uniformiteti i formateve të raportimit për publikun.

Raporti i realizimit të treguesve financiarë të Buxhetit të Bashkisë Kukës (Shtojca 5)

Nr.	Treguesit financiarë	Çfarë kuptojmë?	Formula e llogaritjes	Fakti viti 2021	Fakti viti 2022	Plani viti 2023	Plani viti 2024	Plani viti 2025	Plani viti 2026	Plani viti 2027
1	Raporti i shpenzimeve të përgjithshme ndaj të ardhurave të përgjithshme	Ky raport tregon shpenzimet si një përqindje kundrejt të ardhurave – raporti tregon sesa shpenzon Bashkia Kukës për ofrimin e shërbimeve publike. Tregon marrëdhënien midis flukseve hyrëse të të ardhurave me flukset dalëse të shpenzimeve.	$\frac{\text{Shpenzime}}{\text{Te ardhura}} \cdot 100$	100%	100%	100%	100%	Ne baze te VKB nr.73 date 24.12.2021 , është në përfundim planifikim iper PBA 2022- 2024	Ne baze te VKB nr.81 date 23.12.2022, është në përfundim planifikimi per PBA 2023- 2025	Ne baze te VKB nr.64 date 22.12.2023, është në përfundim planifikimiper PBA 2024- 2026
2	Raporti i të ardhurave të veta vendore ndaj të ardhurave të përgjithshme	Tregon qëndrueshmërinë fiskale të Bashkisë Kukës. Rritja e raportit në vite tregon se Bashkia Kukës nuk mbështetet vetëm në burime të jashtme (si transfertat e qeverisë qendrore, grantet etj.)	$\frac{\text{TA vendore}}{\text{Te ardhura Pergj}} \cdot 100$	6.6%	6.6%	6.2%	6.2%	Ne baze te VKB nr.73 date 24.12.2021 , është në përfundim planifikim iper PBA 2022- 2024	Ne baze te VKB nr.81 date 23.12.2022, është në përfundim planifikimi per PBA 2023- 2025	Ne baze te VKB nr.64 date 22.12.2023, është në përfundim planifikimiper PBA 2024- 2026
3	Raporti i të ardhurave faktike nga taksat dhe tarifatat vendore ndaj planit të tyre	Një diferencë e madhe ose në rritje midis të ardhurave të arkëtuara dhe atyre të planifikuara përgjatë viteve mund të tregojë një rënie të përgjithshme të ekonomisë vendore. Nëse kjo difference është e përhershme atëherë problem është mbledhja e taksave dhe tarifave vendore që mund të jetë për shkak të procedurave, barrës së lartë fiskale, ose parashikim i pasaktë.	$\frac{\text{TA faktike}}{\text{Te ardhura Pergj}} \cdot 100$	7.9%	7.9%	7.5%	7.5%	Ne baze te VKB nr.73 date 24.12.2021 , është në përfundim planifikim iper PBA 2022- 2024	Ne baze te VKB nr.81 date 23.12.2022, është në përfundim planifikimi per PBA 2023- 2025	Ne baze te VKB nr.64 date 22.12.2023, është në përfundim planifikimiper PBA 2024- 2026
4	Raporti i shpenzimeve për investime kapitale ndaj shpenzimeve të përgjithshme	Një normë e lartë, një menaxhim të mirë të financave vendore duke ofruar përmirësime në shërbimet vendore. Rritja e raportit përgjatë viteve mund të shpjegohet edhe me shërbime shtesë, infrastrukturë e re, pasuri të paluajtshme të shtuara, funksione të reja të marra që kanë nevojë për investime etj.	$\frac{\text{Shp Invest. Kapitale}}{\text{Shpenzime Pergj.}} \cdot 100$	3.6%	3.6%	3.4%	3.4%	Ne baze te VKB nr.73 date 24.12.2021 , është në përfundim planifikim iper PBA 2022- 2024	Ne baze te VKB nr.81 date 23.12.2022, është në përfundim planifikimi per PBA 2023- 2025	Ne baze te VKB nr.64 date 22.12.2023, është në përfundim planifikimiper PBA 2024- 2026

5	Raporti i shpenzimeve për personelin ndaj shpenzimeve të përgjithshme	Rritja në vite e peshës së shpenzimeve të personelit ndaj shpenzimeve të përgjithshme mund të tregojë ulje të shpenzimeve për investime/operative, ose faktin se produktiviteti i personelit është në rënie. Një rritje e këtij raport mund të tregojë gjithashtu se Bashkia Kukës po ofron më shumë shërbime (duke marrë funksionet të reja, duke rritur volumnin e shërbimeve ose cilësinë e tij).	Shpenz. Personeli (Shpenzime Përgj.) • 100	34.5 %	34.5 %	31.6 %	31.6 %	Ne baze te VKB nr.73 date 24.12.2021 , është në përfundim planifikimi per PBA 2022- 2024	Ne baze te VKB nr.81 date 23.12.2022, është në përfundim planifikimi per PBA 2023- 2025	Ne baze te VKB nr.64 date 22.12.2023, është në përfundim planifikimi per PBA 2024- 2026
6	Raporti i huamarrjes afatgjatë ndaj të ardhurave të përgjithshme	Afatgjatë mbi një vit Një raport i ulët tregon që Bashkia Kukës është në gjendje të paguajë detyrimet e saj të borxhit (principali plus interesat). Nëse Bashkia Kukës po paguan një përqindje të lartë të të ardhurave totale në shërbimin e borxhit, ato mund të detyrohen të ulin shërbimet e tjera lokale.	Huamarrje afat gjatë (Te ardhura Përgj.) • 100	0%	0%	0%	0%	Ne baze te VKB nr.73 date 24.12.2021 , është në përfundim planifikimi per PBA 2022- 2024	Ne baze te VKB nr.81 date 23.12.2022, është në përfundim planifikimi per PBA 2023- 2025	Ne baze te VKB nr.64 date 22.12.2023, është në përfundim planifikimi per PBA 2024- 2026
7	Raporti i huamarrjes afatgjatë ndaj të ardhurave të veta	I njëjti interpretim si më sipër. Raporti në këtë rast tregon qartë një varësi midis shërbimit të borxhit / shlyerjes me anë të burimeve të veta financiare të Bashkisë.	Huamarrje afat gjatë (Te ardhura Te veta) • 100	0%	0%	0%	0%	Ne baze te VKB nr.73 date 24.12.2021, është në përfundim planifikimi per PBA 2022- 2024	Ne baze te VKB nr.81 date 23.12.2022, është në përfundim planifikimi per PBA 2023- 2025	Ne baze te VKB nr.64 date 22.12.2023, është në përfundim planifikimi per PBA 2024- 2026
8	Raporti i huamarrjes afatshkurtër ndaj të ardhurave të përgjithshme	Afatshkurtër nën një vit Tregon aftësinë e Bashkisë Kukës për të respektuar detyrimet afatshkurtra. Rritja e detyrimeve korrente afatshkurtra si % kundrejt të ardhurave në fund të vitit tregon një situatë negative në lidhje me likuiditetet dhe / ose problem me shpenzimet të cilat realizohen me borxh. Një raport i ulët tregon se borxhi afatshkurtër mund të shlyhet lehtësisht me anë të të ardhurave vjetore të Bashkisë Kukës.	Huamarrje afat shkurtër (Te ardhura Përgj.) • 100	0%	0%	0%	0%	Ne baze te VKB nr.73 date 24.12.2021, është në përfundim planifikimi per PBA 2022- 2024	Ne baze te VKB nr.81 date 23.12.2022, është në përfundim planifikimi per PBA 2023- 2025	Ne baze te VKB nr.64 date 22.12.2023, është në përfundim planifikimi per PBA 2024- 2026
9	Raporti i detyrimeve tatimore të përkëtuara në kohë ndaj të ardhurave tatimore	Përfaqëson detyrimet fiskale të papaguara në kohë për Bashkinë Kukës. Një normë e lartë e detyrimeve të akumuluar kundrejt totalit të të ardhurave të Bashkisë Kukës nga taksat dhe tarifat mund të tregojë procedura jo të mira; barrë e lartë fiskale; rënie të ekonomisë vendore.	Detyrime Tatimore (Te ardhura Tatimore) • 100	4.8%	4.6%	4.6%	4.2%	Ne baze te VKB nr.73 date 24.12.2021, është në përfundim planifikimi per PBA 2022- 2024	Ne baze te VKB nr.81 date 23.12.2022, është në përfundim planifikimi per PBA 2023- 2025	Ne baze te VKB nr.64 date 22.12.2023, është në përfundim planifikimi per PBA 2024- 2026

10	Raporti i shpenzimeve për partneritetet publike-private ndaj shpenzimeve të përgjithshme	Raporti i shpenzimeve që bën Bashkia Kukës si pjesë e të gjitha skemave PPP ku ajo është palë nuk duhet të jetë më shumë sesa 5% e shpenzimeve të përgjithshme të saj. Raporte më të larta tregojnë se Bashkia Kukës është në kundërshtim me parashikimet ligjore numër 9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar.	Shpenzime PPP (Shpenzime Përgjith.) • 100	0%	0%	0%	0%	Ne baze të VKB nr.73 date 24.12.2021, është në përfundim planifikimi për PBA 2022- 2024	Ne baze të VKB nr.81 date 23.12.2022, është në përfundim planifikimi për PBA 2023- 2025	Ne baze të VKB nr.64 date 22.12.2023, është në përfundim planifikimi për PBA 2024- 2026
11	Raporti i shpenzimeve për politikat e kujdesit shoqëror ndaj shpenzimeve të përgjithshme	Një raport i lartë tregon ndërmarrjen e politikave të reja ose masa në fushën e shërbimeve sociale ose rritje të numrit të përfituesve të këtyre politikave/masave.	Shpenzim Kujdes Soc (Shpenzime Përgjith.) • 100	53.6%	50.0%	50.0%	49%	Ne baze të VKB nr.73 date 24.12.2021, është në përfundim planifikimi për PBA 2022- 2024	Ne baze të VKB nr.81 date 23.12.2022, është në përfundim planifikimi për PBA 2023- 2025	Ne baze të VKB nr.64 date 22.12.2023, është në përfundim planifikimi për PBA 2024- 2026
12	Raporti i shpenzimeve për politikat që mbështesin barazinë gjinore ndaj shpenzimeve të përgjithshme	Bashkia Kukës përdor fonde për politika që Mbështesin çështjet gjinore dhe një raport në rritje përgjatë viteve tregon angazhimin në rritje të njësisë në këtë fushë.	Shpen Barazi Gjinore (Shpenzime Përgjith.) • 100	0%	0%	0%	0%	Ne baze të VKB nr.73 date 24.12.2021, është në përfundim planifikimi për PBA 2022- 2024	Ne baze të VKB nr.81 date 23.12.2022, është në përfundim planifikimi për PBA 2023- 2025	Ne baze të VKB nr.64 date 22.12.2023, është në përfundim planifikimi për PBA 2024- 2026

Relacion shpjegues realizimit treguesve financiarë Buxheti Bashkisë Kukës (Shtojca 2)

Hartimi i këtij raporti dhe konkretisht i analizës dhe raportimi i treguesve financiarë i ka mundësuar Bashkisë Kukës të kuptojë më mirë aspektet financiare të saj dhe 14 njësi administrative.

Ky informacion i kombinuar me elementë të tjerë ekonomik, demografik dhe social të Bashkisë Kukës ndihmon marrjen e masave përkatëse nga ana e Bashkisë Kukës dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për të bërë krahasime midis tyre dhe mbajtjen e financave vendore nën monitorim. Me anë të treguesve financiarë merret informacion në lidhje me:

- ☐ Prioritetet e Bashkisë Kukës;_____
- ☐ Burimet që ka në dispozicion Bashkia Kukës;
- ☐ Sa varet Bashkia Kukës nga transfertat e qeverisë qëndrore?
- ☐ A ruhet disiplina fiskale në Bashkinë Kukës?
- ☐ A ka risqe fiskale që kërkojnë një vëmendje të veçantë në Bashkinë Kukës?

Këtyre pyetjeve u jepet përgjigje në dokumentin e Regjistrit të Riskut për Bashkinë Kukës për vitin 2024, nënshkruar me datë 09.02.2024 dhe raportuar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me Shkresën nr.1064 datë 22.02.2024 “Dërgim dokumentacioni”.



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
BASHKIA KUKËS

Shtojca 7 A

Regjistri i Riskut

Emri i Organizatës:	Raportuar nga :
Bashkia Kukës	Koordinatori i Riskut Agron NUREDINAJ
Misioni i Bashkisë Kukës është të sigurojë qeverisjen në një nivel sa më afër qytetarëve. Si njësi e nivelit bazë, ajo do të ketë si mision garantimin e vetëqeverisjes në përputhje me kërkesat e Kartës Europiane të Autonomisë Vendore. Ka synim kryesor plotësimin sa më të mirë të nevojave dhe kërkesave të komuniteteve përkatëse, nëpërmjet arritjes së një niveli sa më të lartë shërbimesh, në dobi të një zhvillimi të balancuar me qëllim përfundimtar standarte të larta të cilësisë së jetesës në territorin nën administrim. Marrëdhëniet e Bashkisë Kukës me organet e pushtetit qendror, do të bazohen në parimin e subsidiaritetit, të konsultimit dhe të bashkëpunimit për zgjidhjen e problemeve të përbashkëta. Në kuadër të reformës së decentralizimit, përgjegjësitë e njëjësive të vetëqeverisjes vendore janë duke u bërë gjithnjë e më të rëndësishme dhe të shumëllojshme.	
	Muaji Shkurt - 2024

BASHKIA KUKËS

REGJISTRI I RISKUT DHE HARTA E RISKUT PËR VITIN FINANCIAR 2024

FAQE 1

Harta e Riskut të Bashkisë Kukës, viti financiar 2024

Mundësia

I lartë



I Mesëm



I Ulët



Ndikimi

I Ulët

I mesëm

I Lartë

KOORDINATOR I GMS-së

Agron NUREDINAJ

BASHKIA KUKËS

REGJISTRI I RISKUT DHE HARTA E RISKUT PËR VITIN FINANCIAR 2024


FAQE 29

Drejtoria e Financës dhe Buxhetit e Bashkisë Kukës, ka përgatitur gjatë vitit 2024, ka përditësuar dhe po raporton para Këshillit Bashkiak dhe në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, treguesit financiarë të realizimit të Buxhetit të periudhës Janar – Gusht 2024. Të dhënat për të llogaritur këta tregues financiarë janë të dhëna faktike që egzistojnë në ditarët dhe regjistrat e bankës, ditarët dhe regjistrat e shpenzimeve si dhe në pasqyrat financiare të Bashkisë Kukës, duke u konfirmuar nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë (SIFQ)nëpërmjet Degës së Thesarit Kukës.

Ndërsa të dhënat e planifikuara për treguesit janë llogaritur duke përdorur të dhënat nga buxheti afatmesëm 2024 - 2026 të Bashkisë Kukës, miratuar me vendimin Nr.66 datë 22.12.2023 të Këshillit të Bashkisë konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Kukës me shkresën nr.1/28 datë 05.01.2024 “Verifikim i ligjshmërisë së aktit” dhe përllogaritja e këtyre treguesvefinanciarë është mbështetur

në të dhënat që sigurohen nga Instrumenti i Planifikimit Financiar(IPF), instrument i cili do të përdoret për herë të fundit gjatë vitit 2024, pasi raportet e viteve të tjera do të gjenerohen nga SMBV(Sistemi i Menaxhimit të Buxhetit Vendor) sipas Udhëzimit Nr. 3, datë 28.02.2024 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2025-2027 dhe Manualit të Përdorimit të Sistemit të Menaxhimit të Buxhetit Vendor.

Raport për realizimin e investimeve të Bashkisë Kukës në lekë (Aneksi nr.5)



Të dhënat në grafikun e mësipërm tregojnë volumin e investimeve me fonde të veta dhe investimet e Bashkisë Kukës të financuara nga fondet e qeverisë qendrore, por megjithatë nuk mund të lihet pa përmendur fakti që disa nga procedurat e tenderimeve nuk janë mbyllur me mbylljen e vitit financiar, megjithatë volumi i përgjithshëm i investimeve kap shifrën **147,097** mijë lekë ose në masën **81 %** e totalit të përgjithshëm të shpenzimeve të buxhetuara për investime.

Treguesit e raportit të gjendjes financiare të Bashkisë Kukës (Shtojca 6)

Raporti tetëmuor për Treguesit e raportit të gjendjes financiare të Bashkisë Kukës, dërgohet në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë në përpunime me afatet e përcaktuara në udhëzimin nr. 22, datë 30.07.2018, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësisë të vetëqeverisjes vendore”, dhe formateve të aneksit 1, dhe aneksit 2, bashkëlidhur udhëzimit.

“Gjendje normale financiare”, në kuptimin e këtij udhëzimi quhet rasti kur detyrimi financiar i prapambetur është nën 15% të shpenzimeve vjetore faktike, dhe që është në një afat nën 60 ditë kalendarike (30 ditë për procedurat e aprovimit në njësisë shpenzuese dhe 30 ditë për procedurat e miratimit e procesimit të pagesës në degën e thesarit).

Bashkia Kukës është angazhuar që jo vetëm të mos krijojë borxhe të reja por të likujdojë detyrimet e trashëguara duke respektuar dhe aktet ligjore, kështu në zbatim edhe të Aktit Normativ nr.6 datë 14.12.2023 Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr.84/2022 datë 25.11.2022 “Për buxhetin e vitit 2023” Bashkia Kukës me VKB Nr. Nr.04 dt.26.01.2024, ka vendosur Ndryshimin (shtesën), në buxhetin e Bashkisë Kukës për vitin 2024 “Likujdim i detyrimeve të prapambetura në vlerën 46,309,724 (dyzet e gjashtë milion, e treqind e nëntë mijë, e shtatëqind e njëzet e katër) lekë”, sipas Aktit Normativ nr.6 datë 14.12.2023 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr.84/2022 datë 25.11.2022 “Për buxhetin e vitit 2023”

Për periudhën Janar-Gusht 2024 Bashkia Kukës me Shkresën Nr.815 prot. datë 24.02.2025 “Dërgim i raportit të vetëvlerësimit, situata financiare Janar – Dhjetor 2024” të Bashkisë Kukës, sipas tabelave; Aneksi 1: Detyrimet ndaj të tretëve sipas vjetërsisë së tyre, situata financiare normale dhe rastet e vështirësive financiare; Aneksi 2: Treguesit fiskalë të konsoliduar të njësisë të vetëqverisjes vendore por edhe planin e hartuar për likuidimin e tyre, pasi në shkresat e Ministrisë Financave dhe Ekonomisë “Dërgohen mendimet për Raportin e konsoliduar të monitorimit të buxhetit” për bashkinë Kukës jepen edhe rekomandime të cilat ne do t’i raportojmë për çdo periudhë katëmuje.

 REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA KUKËS DREJTORIA FINANCËS DHE BUXHETIT	
Nr. <u>815</u> Prot	Kukës, <u>24.02</u> .2025
 Lënda: Dërgim i raportit të vetëvlerësimit, situata financiare Janar – Dhjetor 2024	
Drejtuar : Ministrisë Financave Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit Drejtoria e Financave Vendore Tiranë	
Në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore” të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, si dhe sipas pikave 117, 118, 119, 120 dhe 126/1 të Udhëzimit Plotësues nr.1, datë 24.01.2024, të Ministrisë Financave, “Për Zbatimin e Buxhetit të Vitit 2024”, Udhëzimit nr. 35, datë 29.12.2023, “Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për NJVQV-të”, pika 52, Bashkia Kukës bashkëngjitur ju dërgon: • “Raportin e vetëvlerësimit për situatën e gjendjes financiare Janar – Dhjetor 2024” të Bashkisë Kukës, sipas tabelës bashkëlidhur. • “Planin për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” për periudhën afatmesme 2025-2027” të Bashkisë Kukës, sipas tabelës bashkëlidhur. • “Treguesit Fiskalë të Konsoliduar të Bashkisë Kukës”, sipas tabelës bashkëlidhur. <i>Faleminderit për mirëkuptimin.</i>  KRYETARI Albert HALILAJ	
Sheshi “Skënderbej”, Kukës, Lagja 5. Kodë postar: 8500, Telefon: (024) 225-110, web: kukesi.gov.al, E-mail: info@kukesi.gov.al	

BASHKIA KUKËS

Detajimet ndaj të tretëve sipas vjetërimit të tyre, situata financiare normale dhe rastet e vështirësive financiare

Përfaqja Janar - Dhjetor 2024

V.R.	Klasifikimi	Stoku në vlerë	Shpenzime vjetore faktike për NJVQV-nd	Stoka/Shpenzime vjetore faktike të NJVQV-nd
I	Blerje (a,b)	0		
II	Hua afatgjatë	0		
	a.1) Mbledhjet financiare (kurorë, grua financiare, anëtarësi epi)			
	a.2) Tituj të emetuar			
	a.3) Çertifikatë për xjerrje			
b	Hua afatshkurtyr	0		
	b.1) Mbledhjet financiare (kurorë, grua financiare, anëtarësi epi)			
	b.2) Tituj të emetuar			
	a.3) Çertifikatë për xjerrje			
III	Detajimet e prapambetara	117,163,943		13.36%
IV	Detajimet e prapambetara			
	a.1) Vlerat e Gjendjes			
	a.2) Det. Prap. Shërbime	2,562,222		
	a.3) Det. Prap. Shërbime	101,854,987		
	a.4) Det. Prap. Mbledhjet	0		
	a.5) Det. Prap. Investime	11,516,716		
	a.6) Det. Prap. Kurrizimi - TVSH	0		
	a.7) Det. Prap. Te Tjera	1,629,478		
	a.8) Det. Prap. Shërbime	0		
	a.9) Det. Prap. Shërbime	0		
	a.10) Det. Prap. Ardh. Financiare	0		
	a.11) Det. Prap. Taksat - Taksat	0		
	a.12) Det. Prap. Taksat	0		
	a.13) Det. Prap. Taksat	0		
	a.14) Det. Prap. Taksat	0		
	a.15) Det. Prap. Taksat	0		
	a.16) Det. Prap. Taksat	0		
	a.17) Det. Prap. Taksat	0		
	a.18) Det. Prap. Taksat	0		
	a.19) Det. Prap. Taksat	0		
	a.20) Det. Prap. Taksat	0		
III	Total (III)	117,163,943	883,428,702	883,428,702

Nëpunësi Zbatues

Ramiz HERENI

Nëpunësi Autorizues

Albert HALILAJ

SHENIME

* Stoka e detajimeve të mbetur duhet të zikurojë me vlerën e detajimeve në sistemin e theksuar dritë në periudhën për të cilën kjo llogaritje është bërë. Në rast se kjo nuk rezultoi të kësaj rregullimi në detajimet e buxhetit vendor me min. linjë 00, detajime me burim financiar nga buxheti qendror, (në rast Linje apo FSHZH), lumenjtë të përdorimit vlerat e tyre si në tabelën më poshtë.

* Për buxhetin të cilin përfaqësojnë Fondet nga (ndertimi) dhe janë krijuar detajime të përkrahura nga komitat e lidhura, të cilat janë regjistruar në sistemin e theksuar me min. linjë 00, të plotësojnë vlerën e detajimeve të prapambetara në tabelën më poshtë, dhe nuk do të përfshihen këtë vlerë në tabelën më sipër për verifikimin e situatës financiare.

Detajime prapambetuar	Llogaritja ekonomike	Vlera në lekë
Mundësi, linje 005		
FSHZH		
Fondet nga (ndertimi)		

BASHKIA KUKËS

Treguesit fiskalë të Konsoliduar të Njësit të Vetëqeverisjes Vendore

Nr.	EMERTIMI	Vlera për periudhën e raportimit (Janar-Dhjetor 2024)	Vlera e Buxhetit vjetor (Plan 2024)
I	Të ardhurat e Pushtetit Vendor	216,090,607	146,581,426
1	Taksat e veta vendore	51,432,057	61,678,244
a	Taksa mbi pasurinë	18,585,917	17,473,481
b	Biznesi i vogël	616,040	4,367,061
c	Taksa e ndalimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	6,537,418	5,740,117
d	Taksa të tjera vendore	25,492,682	34,102,586
2	Të ardhura jo tatimore	53,695,208	59,637,286
a	Tarifat e shërbimeve publike	37,802,381	28,755,319
b	Tarifa administrative	6,176,489	16,856,185
c	Të tjera jo tatimore	9,716,338	14,025,782
3	Taksa të ndara	111,163,342	25,266,896
a	Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme	37,403	229,582
b	Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura	32,023,476	10,331,197
c	Renta minerare	45,512,324	14,705,117
d	Tatim mbi të ardhurat personale	19,583,861	
e	Të tjera	13,604,278	
II	Shpenzime të Buxhetit Vendor	883,428,702	1,093,034,000
1	Shpenzime Korrente	761,876,296	935,403,000
a	Paga dhe fond i veçantë për paga	470,182,581	508,880,000
b	Kontributi për Sigurime Shoqërore	81,783,735	96,511,000
c	Shpenzime Operative	197,987,335	330,012,000
d	Të tjera korrente	11,920,645	
2	Shpenzime Kapitale	121,552,406	157,631,000
3	Burimet e Financimit	883,428,702	1,093,034,000
a	Të ardhurat e veta vendore	167,324,314	146,581,000
b	Transferta e pakushtëzuar	452,424,084	428,363,000
c	Transferta specifike/transferta e pakushtëzuar sektoriale	263,680,304	279,230,000
d	Të ardhurat e pa planifikuara (jashtë limitit)		238,860,000
e	Financimi i huaj		
f	Huamarrja Vendore Vjetore		

Nëpunësi Zbatues

Ramiz HERENI

Nëpunësi Autorizues

Albert HALILAJ

BASHKIA KUKËS

Plani i shlyerjes së detyrimeve të prapambetura për tre vitet në vazhdim 2025-2027

Shuma e parashikuar për shlyerje përgjatë tre viteve						
Nr.	Bashkia/Këshilli i Qarkut	Detyrimi i mbetur deri në Gusht 2024	Viti 2025	Viti 2026	Viti 2027	Diferencë (Fakt-Plan)
	BASHKIA KUKËS	117,163,943	51,743,000	32,313,021	30,000,000	3,107,922

Shënim

"Detyrimi i mbetur deri me 31 Dhjetor" duhet të jetë i rakorduar me vlerën e detyrimeve në sistemin e thesarit

Nëpunësi Zbatues

Ramiz HERENI

Nëpunësi Autorizues

Albert HAILLAD

Informojmë Këshillin se Raporti periodik me të dhënat e monitorimit të zbatimit të buxhetit për periudhën 12-mujore Janar - Dhjetor 2024, përmban të dhëna të cilat duhet të bëhen pjesë e Raportit Kombëtar të Performancës së Bashkive pranë Agjencisë për Mbeshtetjen e Veteqeverisjes Vendore, raport i cili si pjesë e një ushtrimi kombëtar, që Qeveria bën për të kuptuar se si është situata me bashkitë dhe sesi po ecin ato në realizimin e funksioneve të tyre, bën të mundur rritjen e mëtejshme të transparencës ndaj publikut.

Vlerësimi i Proçeseve të Konsultimit Publik në Bashkinë Kukës**(Shtojca 7)**

Rrjeti i organizatave të shoqërisë civile shqiptare “Përballja e Ofertave Politike – POP” (ku bëjnë pjesë organizatat jofitimprurëse: Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim”, Tiranë; Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës; Qendra Rinore Vlorë, Epoka e Re, Fier; Intelktualët e Rinj Shpresë, Shkodër; Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë; Qendra për Progres Rinor, Kukës, Gruaja në Zhvillim, Korçë; Hapa të Lehtë, Vau i Dejës; Tjetër Vizion, Elbasan) mbështetur nga “Olof Palme International Center” dhe “National Endowment for Democracy” duke synuar të rrisin debatin publik dhe informacionin te qytetarët si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre, përmes aktiviteteve të këtij projekti kanë ushtruar ndikim në forcimin e demokracisë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien.

Në këtë këndvështrim në periudhën Prill – Qershor 2024, është realizuar studimi “Transparenca dhe Përgjegjësia në Nivel Vendor - Vlerësimi i Proçeseve të Konsultimit Publik”. Studimi ka synuar të vlerësojë situatën në 10 bashkitë e targetuara (Tiranë, Durrës, Vlorë, Pukë, Elbasan,

Fier, Kukës, Shkodër, Vau i Dejës, Korçë) për periudhën Shtator 2023 – Maj 2024, për të pasqyruar situatën e realizimit të njoftimit dhe konsultimit publik në këto njësi të qeverisjes vendore.

Në Kukës, studimi është përgatitur nga Qendra për Progres Rinor, organizatë jo fitimprurëse mjaft e njohur për aktivitetin e saj jo vetëm në Kukës por në të gjithë rajonin dhe më gjërë, anëtare e Rrjetit POP, me synimin kryesor që organizatat lokale të veprojnë si grupe presioni për të advokuar në qeverisjen vendore për të identifikuar prioritetet e zhvillimit, në mënyrë që politikat dhe programet të bazohen në nevojat lokale, si dhe në mundësitë dhe kapacitetet e disponueshme.

Në vlerësojmë maksimalisht autorët e studimit për gjetjet dhe konstatimet e këtij studimi, për teknikat dhe metodat e përdorura nëpërmjet intervistave, pyetsorëve dhe anketave të zhvilluara, por këtij raporti ne do ti bashkëngjitem vetëm konkluzionet dhe rekomandimet për Administratën e Bashkisë Kukës dhe Këshillin Bashkiak Kukës si aktorët institucional kryesor të përfshirë në këtë studim, duke informuar anëtarët e Këshillit të Bashkisë dhe nëpërmjet tyre të gjithë të interesuarit se ky studim do të publikohet edhe në faqen zyrtare të Bashkisë Kukës, duke përmirësuar kështu qasjen dhe angazhimin administrativ në konsultimet publike për të siguruar që vendimet e qeverisjes vendore të merren së bashku me qytetarët e Kukësit.

Konkluzionet për Bashkinë Kukës:

- Zbatimi i ligjit në fuksion të transparencës, rritjes së bësimit të ndërsjellë – qytetarë – qeverisje – kërkon përpjekje shtesë si nga bashkia ashtu edhe nga këshilli bashkiak.
- Procesi zhvillohet në mënyrë të unifikuar dhe në mënyrë të vazhdueshme sipas procedurave të përcaktuara në ligj; përpjekje duhet të bëhen për të rritur cilësinë dhe sasinë e proceseve të konsultuara ashtu edhe shtim të kanaleve të komunikimit.
- Mungesa e komunikimit me qytetarët, mos përdorimi i medias lokale, nxitja e debateve publike janë gjetje të cilat meritojnë vëmendje dhe përkushtim në fuksion të përomrësimit të proceseve të konsultimit publik.
- Bashkia Kukës prej vitesh realizon proceset e njoftimit dhe konsultimit publik dhe në faqen e internetit janë vendosur informacion i qartë dhe i detajuar mbi procesin e njoftimit dhe konsultimit publik në të gjitha fazat, duke filluar nga publikimi i projekt-aktit, marrja e komenteve dhe rekomandimeve për përmirësimin e tij, organizimin e debateve publike e deri te miratimi i aktit përfundimtar.
- Programi i rishikuar i transparencës, përveç vendosjes së një personi përgjegjës në rolin e Koordinatorit të Programit të Transparencës, mund të sjellë dhe ndryshime konkrete në administrimin dhe publikimin e të dhënave e dokumenteve që bashkia dhe Këshilli Bashkiak KB, prodhojnë në fuksion të rritjes së transparencës dhe vendimarrjes.
- Plotësimi i ëeb faqes së bashkisë me të gjithë informacionin e mundshëm i cili mungon, përmirëson aksesin on linë të dokumentave dhe rrit transparencën

Konkluzionet për Këshillin Bashkiak Kukës:

- Të gjithë të intervistuarit vlerësojnë shumë të rëndësishëm informimin dhe njoftimin e qytetarëve për projekt-aktet që miratojnë anëtarët e Këshillit Bashkiak (KB). Informimi është përmirësuar përmes transmetimeve live të mbledhjeve të KB dhe rritjes së ndërveprimit me publikun përmes mediave sociale dhe faqes së internetit të këshillit.
- Këshillimi me bashkësinë, konsiderohet shumë i rëndësishëm për mbledhjen e informacionit dhe rekomandimeve që janë afër nevojave të komunitetit. Anëtarët e KB kanë qenë prezentë në shumë dëgjesa publike por bazuar në rregulloret e tyre ata duhet të marrin rol drejtues dhe ti realizojnë proceset edhe në mënyrë të pavarur nga bashkia.
- Aëtarët e KB njohin mirë bazën ligjore dhe përpiqen të zbatojnë procedurat e parashikuara në rregulloret, megjithatë ka pengesa që pengojnë zbatimin e plotë të këtyre procedurave në praktikë. Njohja e bazës ligjore përbën sfidë dhe kërkon kohë për t'u përshtatur me situatën reale.

Rekomandimet që po paraqesim përveçse kontribuojnë në zbatimin efektiv dhe cilësor të ligjit, ndihmojnë që procesi i konsultimit të mos mbetet formal, por t'i shërbejë qëllimit që ai ka në funksion të: (i) një qeverisjeje më të hapur, transparente e për pasojë, më demokratike; (ii) rritjes së shkallës së zbatimit të legjislacionit, në kuadër të pranimi më të gjerë të tij nga publiku.

- Për sa kohë që ekzistojnë mekanizma dhe modele të mirëqeverisjes, bashkia duhet të vijojë të kërkojë, adaptojë e praktikojë alternativa dhe forma ku qytetarët, grupet e interesit dhe shoqëria civile të marrin pjesë në vendimmarrje dhe të shihen si partnerë të domosdoshëm të procesit të konsultimit publik.
- Duke qenë se ka një bazë të dhënash të plotë mbi procesin e konsultimit publik, përpjekje duhet të behen që sa me shumë qytetarë ti aksesojnë sipas interesit dhe nevojës.
- Rregulloret e aprovuara nga Këshilli bashkiak, duhet të jenë të njohura nga vetë anëtarët dhe të jenë udhëzues në punën e tyre për ti zbatuar në vendimet që ata marrin, ndërsa kërkohet që për disa procese të veçanta të Konsultimit Publik, vetë Këshilli duhet të marrë rol drejtues në fillimin dhe realizimin e tyre.
- Rekomandohet që informacioni i publikuar në faqen e internetit të jetë miqësor për përdoruesit, duke u dhënë me tepër akses në të drejtat e tyre si dhe faqja të pasurohet me informacion të plotë dhe shterrues.
- Është e nevojshme të përmirësohet kontrolli i cilësisë së konsultimeve publike dhe të sigurohet ndjekja e tyre e duhur. Gjithashtu, duhet të bëhen përpjekje shtesë për të inkurajuar pjesëmarrjen e palëve të interesuara, veçanërisht të shoqërisë civile dhe qytetare, në sasi dhe cilësi.
- Këshilli Bashkiak duhet të intensifikojë fushatat e ndërgjegjësimi për rëndësinë e pjesëmarrjes qytetare në dëgjimet publike pasi përveçse në raste të veçanta, për komunitete të caktuara me interes, pjesëmarrja qytetare mbetet sfidë dhe në nivel të ulët cilësor.
- Përdorimi i medias lokale tradicionale si platforma diskutimi dhe komunikimi me publikun, është shumë e rëndësishme dhe do të kontribuonte drejtpërdrejt në rritje të ndërveprimit dhe besimit ndërmjet qytetarëve dhe qeverisjes.
- Zbatimi i metodave të reja për të inkurajuar pjesëmarrjen aktive të qytetarëve, si p.sh., platforma interaktive online dhe aktivitete në komunitet do të risin besimin e publikut.
- Rekomandohet zhvillimi i mekanizmave të rinj për matjen e kënaqësisë së qytetarëve dhe për përmirësimin e ndërveprimit me ta.
- Përdorimi më i gjerë i seancave dëgjimore dhe takimeve në komunitet për të siguruar një përfshirje më të gjerë dhe efektive të qytetarëve, jo vetëm për projekt akte apo procese të detyrueshme ligjore.

Raporti i konsoliduar i zbatimit të buxhetit të Bashkisë Kukës, Janar – Dhjetor 2024 publikohet nga Bashkia Kukës në faqen zyrtare të saj dhe me kërkesë të grupeve të ndryshme të interesit apo personave të interesuar mund të printohet në disa kopje dhe të vihet në dispozicion të tyre, kundrejt një pagese të pranueshme (vetëm vlera e fletëve të printuara), për të gjithë personat e interesuar, ky raport pasi të miratohet nga mbledhja e Këshillit Bashkiak në mbledhjen e radhës do të bëhet publik në adresën: <https://kukesi.gov.al/raporte/>

DREJTORI

Ramiz HERENI

